VENDIM
Nr. 318, datë 6.5.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 398, DATË 9.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN E DISBALANCAVE TË SHKAKTUARA NGA PRODHUESIT ME PËRPARËSI TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 99, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kreun IV, të vendimit nr. 398, datë 9.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin e disbalancave të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 dhe 2, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"1. Në rolin e tij si lider i grupit të balancimit, OER-ja do të alokojë te prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike kostot totale mujore të balancimit në përpjesëtim me prodhimin e matur të energjisë.

2. Në rast se grupi i balancimit ka në përbërje dhe palë të tjera përgjegjëse balancuese, të ndryshme nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, atëherë lideri i grupit të balancimit do të alokojë te të gjithë pjesëmarrësit e grupit kostot totale mujore të balancimit, sipas formulës së mëposhtme:

$$VFD\ (PPB)_{i=1-n} = (FND_{LGB} + VN) * \frac{(Energji\ e\ matur)_{PPB_{i=1..n}}}{\sum_{i=1}^{n} (Energji\ e\ matur)_{PPB_i}}$$

ku:

VFD – vlera e faturës së disbalancave për palën përgjegjëse balancuese;

FND_{LGB} – vlera që rezulton nga netimi i faturave të disbalancave pozitive dhe negative për liderin e grupit të balancimit;

VN – vlera që rezulton nga netimi i sasisë së disbalancave pozitive dhe negative për liderin e grupit të balancimit, shumëzuar me çmimin/njësi të kontratës së energjisë elektrike ndërmjet prodhuesit publik dhe "Furnizuesit të Shërbimit Universal" sh.a., kontratë e lidhur në kuadrin e Shërbimit Universal të Furnizimit;

(PPB)i=i..n – palët përgjegjëse balancuese, anëtarë të grupit të balancimit;

(Energji e matur)[MWh] – sasia e energjisë totale e prodhuar dhe e konsumuar (në vlerë absolute) nga të gjitha palët përgjegjëse balancuese, anëtarë të grupit të balancimit të Operatorit të Energjisë së Rinovueshme.".

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1. Vlera neto (VN) reflektohet në pagesën totale të anëtarit të grupit të balancimit, që ofron Shërbimin Universal të Furnizimit.".

II. Ngarkohen prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a., "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a., Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. dhe Operatori i Energjisë së Rinovueshme sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama